



## DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM ME RASTIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM ONLINE

Formulari online i kërkesës për rimbursim duhet plotësuar saktë në të gjitha fushat e kërkuara.

Rekomandohet që të gjitha kërkesat për rimbursim me vlera të ulta duhet të grumbullohen deri sa të arrijnë shumën 30.00€ - maksimum 500.00€ dhe pastaj të raportohen online. Nëse kërkesat për rimbursim brenda 60 ditësh nuk e arrijnë këtë shumë atëherë i siguruari mund të dorëzoj në SIGAL kërkesën për rimbursim edhe nën këtë vlerë. Mbi vlerën 500.00€ kërkesat duhet të dorëzohen me dokumentacionin fizik origjinal në SIGAL.

1. Kërkesa për Rimbursim (*me fokus të veçantë plotësoni fushat e cekura më rastin e paraqitjes së parakërkesës si me poshtë dhe bashkëlidhni dokumentet e nevojshme. Për me shumë shiko video tutorialin [Portali i Klientit - Kërkesat për Rimbursim Shëndetësore - YouTube](#)*):
  - a. Plotësohet numri personal apo numri i policës së sigurimit
  - b. Data e aksidentit (*është data e parë marrjes së shërbimit mjekësor në institucionin mjekësor. Në rast se keni me shumë së një kupon fiskal, atëherë duhet të regjistrohet data e kuponit fiskal me të vjetër*).
  - c. Pasi të plotësoni fushat (Numri personal, data e kuponit fiskal dhe pas konfirmimit)
    - Konfirmoj se kam lexuar dhe jam pajtuar e përcaktimet, kushtet, autorizimin dhe jap pëlqimin për marrjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke klikuar "Vazhdo" në mënyre automatike lexohen të dhënat nga polica për të vazhduar me paraqitjen e parakërkesës.*
  - b. Numri i telefonit
  - c. Adresa dhe e-mail adresa
  - d. Vlerat e kërkuara për rimbursim
  - e. Emër/Mbiemër dhe numrin e llogarisë së përfituesit etj.
2. Raportet mjekësore të kompletuara (Duhet të bashkëlidhen të skanuara apo të fotografuara nga origjinali).
4. Rezultatet e analizave, MRI, CT, RTG, UT dhe të tjera nëse keni kryer (Duhet të bashkëlidhen të skanuara apo të fotografuara nga origjinali).
5. Kuponat fiskal origjinal (Duhet të bashkëlidhen të skanuara apo të fotografuara nga origjinali)
6. Pasaporta apo letërnjoftimi dhe ID kartës së sigurimit të shëndetit (Duhet të bashkëlidhen të skanuara apo të fotografuara nga origjinali).
8. Dokumente të tjera të cilat ju i shihni si të nevojshme për vlerësimin e kërkesës për rimbursim.

Para se të dërgoni dokumentet mjekësorë, Kuponat fiskal etj. sigurohuni që mos t'ju mungojë asgjë. Nëse kërkesat tuaja nuk i kanë të gjitha informacionet dhe dokumentet e nevojshme, ne mund t'ju kërkojmë të ri paraqisni kërkesën tuaj. Gjithashtu, pajtoheni



qe jeni të detyruar t'i mbani origjinalet për 12 muaj nga data paraqitjes se kërkesës. Në rast se ju kërkohet nga SIGAL Uniqa te prezantohen dokumentet origjinale, Kuponat fiskal origjinal, atëherë të njëjtat duhet të dorëzohen sipas kërkesës.

Për çdo pyetje, koment apo ankesë lidhur me shërbimet e Sigurimit privat te shëndetit, luteni të na shkruani në:

**Departamenti i dëmeve shëndetësore:** [demetshendetsore@uniqa-ks.com](mailto:demetshendetsore@uniqa-ks.com);  
[info@uniqa-ks.com](mailto:info@uniqa-ks.com)

Adresa Postare:

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. Kosovë**

**Adresa: Rr. "Ukshin Hoti", Nr.19, Pejton, Prishtinë, Kosovë**